



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT

Shërbimi: Ndriçimi publik

ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS

GRUPI I PUNËS		
#	Emri	Pozitat e punës
1	<i>Gjokë Lleshaj</i>	Koordinator i grupit – Drejtor i shërbimeve Publike
2	Dardan Bashota	Anëtar i GP – Zyrtar i ambientit
3	Milaim Musliu	Anëtar – KRM “Ambienti”
4	Elmi Krasniqi	Anëtar –Inspektor i shërbimeve publike
5	Silva Rashkoviq	Anëtare – Zyra komunale për komunitete dhe kthim
6	Artan Prenaj	Anëtar – Shoqëria civlie
7	Rrahman Gashi	Anëtar –Shoqëria civlie
8	Sllagjan Mikic	Anëtar – përfaqësues i komunitetit
9	Lekë Bekaj	Anëtar - përfaqësues i komunitetit

Klinë 2015

I. ANALIZA E SITUATËS SË TANISHME

1.1 Informacion i Përgjithshëm për Komunën

Komuna e Klinës, gjendet ne rrafshin e Dukagjinit në anën perendimore të Kosovës rreth 60 km në perendim të kryeqytetit të Kosovës.

Më foton 1. është paraqitur harta e shtrirjes territoriale të komunës se Klinës e siperfaqja e pergjithshme e komunës së Klinës është 309 km².




Foto.1. Shtrirja territoriale e komunës së Klinës

Klina në periudhën e më hershme njihet si vendbanim ilir me emër Chinna, Komuna e Klinës, e themeluar ne vitin 1954 në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit në një hapsirë të pasur me pasuri natyrore.

Komuna e Klinës, me rrethinë ka rreth **38.496 banor**, në qytetin e Klinës jetojnë 5.908 banor ndërsa 32.588 jetojnë në zonat rurale.

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të volitshme për zhvillimin e bujqesisë si p.sh kultivimin e drithrave, pemëve dhe perimeve. Në fshatrat e komunës së Klinës bujqësia është veprimtaria kryesore. Komuna e Klinës përbëhet prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që shtrihen sipas zonave kadastrale.

Në Komunën e Klinës nga regjistrimi i fundit i bërë në vitin 2013 jetojnë **38.496** banor. Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare strukturën e popullsisë e cila dominon në komunën e Klinës.

Zona	Nr. i banorëve	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptjan	Të tjerë	Të pa deklaruar	Nuk kanë qenë në dispozicion
Zona Urbane	5,908	2,892	3,016										
Zona Rurale	32,588	16,301	16,287										
Komuna e Klinës	38,496	19,193	19,303	37,216	98	3	20	78	85	934	23	7	32

Komuna e Klinës ka gjithsejt 54 vendbanime:

#	Vendbanimi	#	Vendbanimi	#	Vendbanimi
1	Klinë*	19	Leskoc	37	Ujmirë
2	Dolc*	20	Radulloc	38	□ abiq
3	Dërsnik*	21	Berkovë*	39	Siqevë
4	Gremnik*	22	Drenoc*	40	Dobërdol
5	Zajm*	23	Grabanicë*	41	Gllarevë
6	Videjë*	24	Dugajevë	42	Rixhevë
7	Deiq	25	Pjetërq i Poshtëm*	43	Caravik
8	Krushevë e Vogël	26	Pjeterq i Epërm*	44	Zabërgjë
9	Gjurgjevik i Vogël	27	Bokshiq*	45	Sferkë
10	Klinafc*	28	Dollovë*	46	Dush
11	Jagodë*	29	Këpuz	47	Volljakë
12	Budisalc*	30	Qeskovë	48	Qypevë
13	Rudicë*	31	Jashanicë*	49	Përqevë
14	Krushevë e Madhe*	32	Pograxhë*	50	Shtupel*
15	Stupë*	33	Resnik*	51	Kërnice*
16	Nagllavë	34	Jelloc	52	Bingjë*
17	Zllakuqan	35	Dush	53	Gracp*
18	Ranoc	36	Gjurgjevik i Madh	54	Dranashiq*

*Vendbanimet në të cilat jeton komuniteti minoritar

Klina kufizohet me gjashtë komuna: Istog, Skenderaj, Malishevë, Rahovec, Gjakovë dhe Pejë. Nëpër qytetin e Klinës kalon edhe vija hekurudhore.


Resurset natyrore, komuna e Klinës është mjaftë e pasur me resurse natyrore duke përfshirë minerale dhe jominerale që është bazë e mirë për tërheqjen e investimeve. Ka një sasi të rezervave të Linjtit, minerale të boksitit, argjilë, rërë dhe zhavor.

Rezervat e linjtit dhe mineralet e boksitit nuk janë në shfrytëzim për momentin, mirëpo në një të ardhme ato si një pasuri edhe mund të shfrytëzohen.


Në komunën e Klinës ka 6,109 familje, rreth 2,100 biznese dhe 61 institucione publike në menaxhim të administratës komunale.

Numri i institucioneve shkollore është 29 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme, ndërsa numri i institucioneve komunale është 15, nga të cilat janë: objekti i administratës komunale, 10 Zyre të vendit dhe 4 institucione kulturore. Objekte shëndetësore në komunën e Klinës janë gjithsej 15, nga të cilat janë: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Klinë, 3 qendra të mjekësisë familjare në fshatrat Zilkakuqan, Ujmirë dhe Sferkë, si dhe 11 ambulanca (punte shëndetësore) në fshatrat: Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Volljakë, Gllarevë, Caravik, Jashanicë, Jashanicë e Epërme, Shtupel dhe Leskoc.

Klinë / Klina



Klinë / Klina



1.2. Gjendja e rrjetit të ndriçimit publik

Rrjeti elektrik i ndriçimit të qytetit mesatarisht është funksional, ky lloj ndriçimi ka nevojë për ndryshim me trupa eficient. Gjatësia e rrugëve komunale në km të asfaltuara dhe të paasfaltuara në zonën urbane është 30 km deri sa në zonën rurale 211 km, gjatësia e rrugëve me ndriçim publik në zonën urbane është 9.8 km, ndërsa gjatësia e rrugëve me ndriçim publik në zonën rurale është rreth 3.45 km. Pra zona urbane është e mbuluar 32.67% me ndriçim publik ndërsa zona rurale 1.64% . Pra Klina nga 241 km rrugë, ka gjithsej 13.25 km rrugë të mbuluara me ndriçim publik që do të thotë 5.5%.

Krahasuar me vitet e mëhershme në vitin 2014 vërehet një përmirësim i gjendjes me ndriçim publik në komunën e Klinës sidomos në zonën urbane.

Rrjeti elektrik i ndriçimit të qytetit është i periudhave të ndryshme: pra kemi ndriçim të ri dhe eficient por kemi edhe ndriçim të vjetruar dhe të stërngarkuar për çka edhe shpeshherë paraqiten defekte të natyrave të ndryshme.

I tërë sistemi i ndriçimit në territorin e komunës së Klinës është përgjegjësi e autoriteteve lokale komunale.

Rrjeti i ndriçimit publik në qytetin e Klinës është kryesisht i ndërtuar me një strukturë të degëzuar dhe të organizuar me system të ndriçimit i cili shfrytëzon trupa ndriçues të llojit të ndryshëm: LED, Zhivë, Natrium, ekonomik dhe të organizuar nëpër pika matëse në trafostacione. Rrjeti i ndriçimit në komunë përbëhet nga 60 trupa ndriçues me sistem LED, 76 trupa ndriçues Zhive, 50 trupa ndriçues Natriumi dhe 194 trupa ndriçues me poça ekonomik. Çdo vit vazhdon zgjerimi rrjetit të ndriçimit të rrugëve si dhe rikonstruimi i rrjetit ekzistues mirëpo ende investimet e vogla nuk mund të përmirësojnë dukshëm sistemin e tërësishëm të ndriçimit në qytet.

Klina ka gjithsej 3 sheshe dhe një (1) park të cilët posedojnë ndriçimin publik: Sheshet janë të përfshira në ndriçimin rrugor ndërsa parku ka ndriçim të veçantë me shtylla metalike në lartësi 4m' me trupa ndriçues prej 20W.

Numri i pikave matëse është 16 nga të cilat 12 në zonën urbane dhe 4 në zonën rurale.

Siq u cek edhe më lartë sistemi i ndriçimit në komunën e Klinës kryesisht është i vjetruar dhe nuk funksionon si duhet.

Gjendja aktuale për ndriçimin publik në komunën e Klinës është si vijon:

56 shtylla me trupa ndriçues Zhive të fuqisë 125W

20 shtylla me trupa ndriçues Zhive të fuqisë 250W

50 shtyllë me trupa ndriçues Natriumi të fuqisë 250W

194 shtylla me trupa ndriçues me drita ekonomike të fuqisë 105W

60shtylla me trupa ndriçues LED të fuqisë 85W

120 shtylla parku me trupa ndriçues me drita ekonomike të fuqisë 20W.

Lloji i shtyllave në të cilat është i shtrirë rrjeti i ndriçimit publik është:

- Shtylla metalike – 140 copë
- Shtylla druri – 23 copë dhe
- Shtylla betoni - 217 copë
- Shtylla ndriçimi në park – 120 copë

Gjatësia e rrugëve me ndriçim sipas vendbanimeve:

- Në qytet ka ndriçim publik në rrugë me gjatësi prej 9,800 m’
- Në Dresnik ka ndriçim publik në rrugë me gjatësi prej 900 m’ (28 trupa ndriçues)
- Në Videjë ka ndriçim publik në rrugë me gjatësi prej 1,300 m’ (28 trupa ndriçues)
- Në Rudicë ka ndriçim publik në rrugë me gjatësi prej 250 m’ (8 trupa ndriçues)
- Në Dolcë ka ndriçim publik në rrugë me gjatësi prej 1,000 m’ (23 trupa ndriçues)
- 1 park me ndriçim përmes 120 trupave ndriçues

Harxhimet e energjisë elektrike për ndriçimin publik, sikur të funksionojnë të gjithë trupat ndriçues dhe atë mesatarisht nga 10 orë pune në ditë, do të ishin:

20 poça Zhive të fuqisë 250 W për 1 orë harxhojnë 5 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 50 kWh në ditë, kurse në vit harxhojnë 18,250 kWh/vit.

56 poça Zhive të fuqisë 125 W për 1 orë harxhojnë 7 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 70 kWh në ditë, kurse për një vit 25,550 kWh/vit.

50 poça Natriumi të fuqisë 250 W për 1 orë harxhojnë 12.5 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 125 kWh në ditë, kurse në vit harxhojnë 45,625 kWh/vit.

194 poça ekonomik të fuqisë 105 W për 1 orë harxhojnë 20.37 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 203.7 kWh në ditë, kurse në vit harxhojnë 74,350 kWh/vit.

60 poça LED 85 W për 1 orë harxhojnë 5.1 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 51 kWh në ditë, kurse në vit harxhojnë 18,615 kWh/vit.

120 poça ekonomik të fuqisë 20 W për 1 orë harxhojnë 2.4 kWh ndërsa për 10 orë harxhojnë 24 kWh në ditë, kurse në vit harxhojnë 8,760 kWh/vit.

I tërë ndriçimi me 500 trupa ndriçues për një vit harxhon 191,150 kWh/vit (191.15 MWh/vit) ose në Euro duke llogaritur me çmimin për kilovat 0.0917 del që për një vit shpenzohen 17,528.46 Euro.

Përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik e ka Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente (DSHPE). Në kuadër të kësaj përgjegjësie DSHPE harton planin/projektin për mirëmbajtje vjetore të ndriçimit publik dhe sipas procedurave të prokurimit-tenderit publik zgjidhet kompania e cila do ta bëjë mirëmbajtjen vjetore të ndriçimit në rrjetin ekzistues të ndriçimit. Derisa zgjerimi i rrjetit planifikohet sipas listës së investimeve kapitale të aprovuar në Kuvend.

1.3. Problemet që lidhen me ndriçimin publik

Ndriçimi publik ekzistues është ndërtuar gjatë periudhave të ndryshme kohore, domethënë krahas me zgjerimin e qytetit dhe me rritjen e numrit të banorëve, e gjithashtu edhe bazuar në numrin e rrugëve të cilat janë ndërtuar me kohën. Nga informacionet e marra prej përfaqësuesit komunal si dhe nga vizitat në terren, është vlerësuar se rreth 5.5% e rrugëve komunale kanë ndriçimit publik, deri sa rreth 80% e ndriçimit ekzistues është funksional. Një pjesë e konsiderueshme e ndriçimit të rrugëve është mjaft i vjetër, me çrast kemi humbje të mëdha për shkak të vjetërsisë së rrjetit dhe pajisjeve si dhe shpenzim të lartë të energjisë për shkak të përdorimit të poçave jo eficient.

Disa nga arsyet për të investuar në ndriçimin publik ekzistues janë:

Kostoja e lartë për mirëmbajtje – sepse rrjeti është shumë i vjetër.



Kostoja e lartë e konsumit të energjisë – sepse poçat janë të zhivës pra shpenzues të lartë të energjisë.

Mbulueshmëri jo e mjaftueshme e rrugëve lokale me ndriçim publik e cila ndikon në sigurinë e qytetarëve gjatë lëvizjes së tyre gjatë orëve të mbrëmjes.

1.4. Opinioni i qytetarëve për shërbimin e ndriçimit publik

Anetaret e grupit punues të komunës së Klinës kanë pranuar se mendimet e qytetarëve janë të vlefshme për matjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve komunale. Përceptimet e qytetarëve mund të kombinohen me matjet e tjera sasiore për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të cilësisë, shtrirjes së shërbimit, prioriteteve dhe nevojave që ata kanë lidhur me këtë shërbim. Në bazë të raportit të anketimit mbi kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet komunale respektivisht me ndriçimin publik kënaqshmëria e qytetarëve me ndriçimin publik të rrugëve dhe hapësirave publike në vitet 2011, 2012 dhe 2013 është shprehur si vijon:

Ndriçimi publik është një shërbim që ka shënuar përmirësime të lehta në 2013 pasi që mbulueshmëria është zgjeruar në zonën urbane dhe lehtë edhe në atë rurale. Edhe kënaqshmëria e qytetarëve sa i përket sigurisë së lëvizjes ka një ngritje të lehtë prej 1% deri sa kënaqshmëria me shërbimin pasur një rënje prej 2%.



Grafiku i me sipërm tregon opinionin e qytetarëve për shërbimin e ndriçimit publik nëkomunën e Klinës marrë nga Raportet e Anketimit Mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale.

Më poshtë është tabela me rezultatet e të gjithë indikatorëve që tregojnë performancën e komunës së Klinës në ofrimin e shërbimit të ndriçimit publik.

Indikatorët	2011/2012	2013/2014	Trendi
% e km. të rrugëve me ndriçim publik në zonat urbane	27%	32.67%	↑
% e km. të rrugëve me ndriçim publik në zonat rurale	0%	1.64%	↑
% e km. të rrugëve me ndriçim publik në zonat urbane dhe rurale	5%	5.5%	↑
% e qytetarëve që pohojnë se ndjehen të sigurt ose deri diku të sigurt gjatë natës (për shkak të ndriçimit)	69%	70%	↑
% e qytetarëve të kënaqur ose diku të kënaqur me ndriçimin publik të rrugëve dhe hapësirave publike	53%	51%	↓

Nga tabela e më sipërme shihet se rezultati i anketimit të qytetarëve i shprehur në përqindje tregon se përqindja e qytetarëve (shprehur të sigurtë gjatë natës për shkak të ndriçimit publik) të rrugëve dhe hapësirave publike gjatë viteve 2012 dhe 2013 ka lëvizur me trend të vogël pozitiv dhe atë nga viti 2012 në vitin 2013. Deri sa kënaqshmëria e qytetarëve për shërbimin e Ndriçimit Publik nga viti 2012 në vitin 2013 ka pësuar një rënje të lehtë në përqindje dhe ky trend tregon se përmirësimi më i nivelit të këtij shërbimi do të jetë një sfidë për komunën e Klinës.

1.5. Ide për përmirësimin e shërbimit të ndriçimit publik

Vënja në zbatim e një sistemi funksional të ndriçimit publik është shumë e rëndësishme për Komunën e Klinës. Duke marrë për bazë sigurinë për qytetarët që ofron ky shërbim dhe uljen e kostos së shpenzimeve komunale për pagesën e energjisë elektrike, investimi në këtë shërbim ka një rëndësi të madhe për qytetarët dhe për autoritetet Komunale drejt zvoglimit të shpenzimeve për energji elektrike.

Rrjeti i ndriçimit publik në komunën e Klinës ka përfunduar vetëm pjesërisht dhe kryesisht ky rrjet ka nevojë për përmirësimin e tij duke përdorur poqa eficient, momentalisht shumica e këtij ndriçimi funksionon me drita Zhive dhe me Natrium.

Në qytet dhe në periferi janë 280 trupa ndriçues.

Që banorët të kenë siguri më të madhe është e nevojshme që të shtrihet rrjeti i ndriçimit sidomos në disa rrugë dhe lagje periferike të qytetit siç janë:

- Rrugët: Marie Shllaku (Nikolla Tesla); Kolë Mirdita; Drini Bardhë; Mirush Dakaj; Vëllezërit Gërvalla; Kadri Zeka; Lidhja e Prizrenit – modernizim;
- Rrugët: Luan Haradinaj; Mulla Kajtaž Broja; Ferat Draga;
- Zona e quajtur Perlina
- Rruga e fshatit Dolls; Rruga e fshatit Dresnik; Rrugangastacioni trenit deri në Klinavë; Rruganë drejtimit të Zllakuqanit pjesërisht; Rruga e Videjes; Rruga Ymer Berisha; Rruga Elena Gjikapjesërisht sidhe
- Rrugët në vendbanimet rurale

Me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik në rrugët komunale Grupi Punues i SIAP-it ka përcaktuar disa aktivitete:

- Modernizimi i shërbimit të ndriçimit – duke bërë ndërrimin e trupave ndriçues ashtu që nga ata me poça zhive të kalohet në ata që shpenzojnë më pak siç janë ata me poça Natriumi (HPS), LED me energji elektrike apo solare. Me këtë proces do të arrihet të rritet kualiteti i ndriçimit, siguria e qytetarëve dhe do të kursehen prej 40% (për poça HPS) deri në 70% (për trupa LED) dhe deri në 100% për sistem solar të ndriçimit. Me kursim të energjisë së konsumuar do të kursehet edhe buxheti për pagesën e energjisë elektrike dhe me këtë do të mund të bëhen zgjerime të rrjetit të cilat nuk do ta ngarkojnë shumë buxhetin komunal për pagesën e energjisë së shpenzuar. Me këtë modernizim do të arrihet që edhe mirëmbajtja e rrjetit do të jetë më e lirë sepse trupat e ri kanë jetëgjatësi më të madhe. Kursimet e bëra buxhetore mund të shfrytëzohen për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik.
- Planifikimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit ku ai mungon në: vendbanimet rurale, në qytet dhe në hapësirat dhe objektet publike (parqe, sheshe, shkolla, ambulanta etj.).

II. Misioni dhe Objektivat e Përgjithshme

Pas analizës detale të gjendjes së ndriçimit publik, të bërë nga ana e Grupit Punues është arritur në përfundim që misioni i përgjithshëm i komunës së Klinës për përmirësimin e shërbimit të ndriçimit publik është:

Të ofrohet një nivel më i mirë i shërbimit të ndriçimit publik për përmirësimin e kushteve dhe sigurisë qytetare në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe sigurisë, duke synuar rritjen e nivelit të mirëqenies së komunitetit.

2.1. Objektivat e Planit të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit

Arritja e këtij misioni do të bëhet e mundur nëpërmjet realizimit të objektivave dhe synimeve si vijon:

Objektivi 1: Zvogëlimi i konsumit të energjisë, sepse ky veprim do të mundësojë edhe realizimin e tri synimeve tjera prioritare. Pra do të mundësojë kursimin e buxhetit komunal dhe rrjedhimisht

mbulimin e zonave të reja me ndriçim (nëpër fshatra dhe sheshe të fshatrave) si dhe rritë nivelin e sigurisë së lëvizjes së qytetarëve.

Objektivi 2: Në periudhe afatgjate, përtej këtij Plani te Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Ndiriçimit Publik, komuna e Klinës do të synoje zgjerimin e mbulueshmërisë me ndriçim publik dhe ndërrimin e infrastrukturës së vjetruar të ndriçimit publik.

Rezultatet e pritëshme që do të arrihen nga realizmi i objektivave janë:

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike
- Kursimi i buxhetit komunal
- Zgjerimi i mbulimit të zonave të reja me ndriçim
- Rritja e nivelit të sigurisë së lëvizjes së qytetarëve gjatë natës
- Rritja e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimin e ndriçimit publik

2.2. Niveli i Synimeve të Shërbimit të Ndrëçimit Publik në Komunën e Klinës

2.2.1. Rezultatet dhe Indikatorët e Synuar të Shërbimit

Rezultatet e Dëshiruara	#	Indikatorët e Rezultateve	Viti bazë 2013/2014	Synimi viti 2015	Synimi viti 2016	Burimi Info
Kritja e nivelit të sigurisë së qytetarëve	1	% e qytetarëve që deklarojnë se ndjehen shumë të sigurt apo deri diku të sigurt gjatë natës (si rezultat i ndriçimit të rrugëve)	70 %	75 %	80 %	Anketa
Zona e mbulimit me shërbimin e ndriçimit është rritur	2	% e km rrugë me ndriçim publik në komunë	6 %	9.5 %	11.6 %	DSHPE
	3	% e km rrugë me ndriçim publik në zonën Urbane	33 %	43 %	60 %	DSHPE
	4	% e km rrugë me ndriçim publik në zonën Rurale	2 %	4.7 %	9.5 %	DSHPE
Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me ndriçimin publik është rritur	5	% e qytetarëve të kënaqur apo deri diku të kënaqur me ndriçimin publik të rrugëve dhe hapësirave publike	51 %	65 %	78 %	Anketa

2.2.2. Indikatorë të tjerë

DEFINICIONI	Viti bazë 2013/2014	Synimi 2015	Synimi 2016	Burimi Informacionit
TE DHËNA				
Euro per mirëmbajtjetë ndriçimit publik	15,000 €	15,000 €	15,000 €	DSHPE
Euro per investime kapitale të ndriçimit publik – zgjerim rrjeti		58,000 €		
Euro për energjinë e shpenzuar të ndriçimit publik	15,000 €	≈ 20,000 €	≈ 30,000€	DSHPE
PRODUKTI:				
Gjatësia totale e rrugëve komunale në qytet, në km	30 km	30 km	30 km	DSHPE
Gjatësia totale e rrugëve me ndriçim publik në qytet-	9.8 km	13 km	18 km	DSHPE
Gjatësia totale e rrugëve komunale në fshatra, në km	211 km	211 km	211 km	DSHPE
Gjatësia totale e rrugëve komunale në fshatra, me ndriçim publik	3.45 km	10 km	20 km	DSHPE
Gjatësia totale e rrugëve me ndriçim publik në qytet dhe fshatra	13.25 km	23 km	28 km	DSHPE
Gjatësia totale e rrugëve në komunën e Klinës	<u>241 km</u>	241 km	241 km	DSHPE
Numri i qytetarëve të anketuar	200	200	200	Anketa, OJQ
Numri i trupave ndriçues (totali) LED 85 W	60	350	800	DSHPE
Numri i trupave ndriçues joeffiçiente Zhivë 125 W	56	0	0	DSHPE
Numri i trupave ndriçues joeffiçiente Zhivë 250 W	20	0	0	DSHPE
Numri i trupave ndriçues Natrium HPS 250 W	50	50	0	DSHPE
Numri i trupave ndriçues ekonomik 105 W	194	194	0	DSHPE
Numri i trupave ndriçues ekonomik – park 20 W	120	120	120	DSHPE
Numri i trupave ndriçues efiçient për zëvendësim të trupave të Zhivës me LED 85 W	0	20	50	DSHPE
Numri i trupave ndriçues efiçient për zëvendësim të trupave të Zhivës me LED 40 W	0	56	0	DSHPE
Numri i trupave ndriçues efiçient për zëvendësim të trupave	0	0	194	DSHPE

ekonomik 105 W me LED 85 W					
Numri pikave matese	16	20	25		DSHPE
Konsumi i energjise kWh/vit	191,150 kW	≈ 240,900 kW	≈ 323,900 kW		DSHPE
EFICIENCA					
Kosto e shërbimit për energjinë e shpenzuar €/ kWh (0.0917 € cent/kWh)	17,528.46 €	≈ 22,090€	≈ 29,700€		DSHPE

III. PLANI I VEPRIMEVE

SIAP për Përmirësimin e Shërbimit të Ndrçimit Publik në Komunën e Klinës synon të arrijë rezultatet dhe produktin, realizmi i të cilave do të sjellin arritjen e objektivave të synuar nga ky Plan.

3.1. Synimi e Rezultateve të Propozuara për vitin 2015

Zbatimi i SIAP në Shërbimin e Ndrçimit Publik synon që gjatë vitit 2015 të arrijë rezultatet si më poshtë:

1. Përmirësimi i shërbimit do të bëjë të mundur që rreth 75 % e qytetarëve që deklarohen se janë të sigurt apo shumë të sigurt gjatë natës (për arsye të ndriçimit të mirë të rrugëve), pra pritet të ketë rritje prej rreth 5% kundrejt 70 % që është vlerësuar në vitin 2013. Matja e treguesit për këtë rezultat do të realizohet nëpërmjet anketës së qytetarëve.
2. Komuna do të synojë të rrisë zonën e mbulimit me shërbimin e ndriçimit si në qytet ashtu edhe në vendbanimet rurale (fshatra). Treguesit e këtij rezultati në vitin 2015 do të synojnë nivelet e 43% në vitin 2015 kundrejt 33% në vitin 2014 për qytetin, dhe 5% kundrejt 2% për fshatrat.
3. Përmirësimet me sistemin e ndriçimit publik do të bëjnë të mundur që përqindja e qytetarëve të cilët janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin e ndriçimit të rritet nga 51% në vitin 2013 në 65% respektivisht në vitin 2015.

4. Gjithashtu përmes modernizimit të ndriçimit të rrugëve dhe atë duke zëvendësuar poçat e zhivës të fuqisë 150 W me poça LED të fuqisë 40 W, pos modernizimit do të arrihet edhe një kursim i shpenzimeve për energjinë e shpenzuar. Kjo do të ndikojë që përkundër shtimit të rrjetit të ri të ndriçimit, shpenzimet e energjisë dhe financave komunale për energjinë e shpenzuar nuk do të rriten por përkundrazi ato do të jenë më të vogla se viti paraprak.

Në bazë të studimeve dhe auditimeve energjetike të ndryshme të kryera në Kosovë dhe në bazë të rekomandimeve të BE dhe rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga masat EE si më të favorshme sa i përketë raportit kosto/kursim, për ndriçim publik është aplikimi i ndiçimit efficient.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shkurtimisht plani i veprimit, i cili përfshin objektivat afatshkurtëra, rezultatet e dëshiruara, hapat e veprimit si dhe nga kush do të realizohen, kur do të realizohen dhe me çfarë kostoje të shpenzimeve.

Disa nga pikat e planit të veprimit janë analizuar paraprakisht, kurse disa të tjera mbeten si detyrë e mëtejshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, si identifikimi i nevojave për rrjet të ri, sigurimi i mjeteve financiare, hartimi i projektit, implementimi dhe mbikëqyrja e projektit, fushata mediale me qytetarë dhe në fund vlerësimi dhe anketimi me qytetarë.

3.2. Plani i Veprimet për Zbatimin e SIAP

	<p>Objektivi 1 dhe 2: zvogëlimi i konsumit të energjisë, kursimin e buxhetit komunal dhe rrjedhimisht mbulimin e zonave të reja me ndriçim si dhe rritjen e nivelit të sigurisë së lëvizjes së qytetarëve.</p> <p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e nivelit të sigurisë së qytetarëve; • Rritjen e zones me mbulim të shërbimit të ndricimit; • Ngritjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me ndriçim publik; • Zvoglimi i shpenzimeve për energjinë e hargjuar për ndriçim publik 			
Veprimet/Aktivitetet	Veprimet/Aktivitetet	Zyrtaret përgjegjës	Afati kohor dhe kosto (€)	
<p>1. Analiza e fizibilitetit të ndriçimit aktual dhe atij të ri</p>	<p>a. Studimi I fizibilitetit për përmirësimin e efijences së sistemit të ndriçimit publik</p> <p>b. Percaktimi I kostove dhe fazave të zbatimit, përfshirë:</p> <p>i. Zevendesimin e trupavendriçues të zhivës 125 W me poça të LED 40 W (rreth 56 trupajo efficient do të zëvendësohet me efficient). Lidhja e Prizrenit – modernizim;</p> <p>ii. Zevendesimin e trupave ndriçues të zhivës 250 W me trupandriçues LED 85 W (rreth 20 trupa jo efficient do të zëvendësohet me efficient)</p>	<p>DSHPE</p> <p>DSHPE</p>	<p>Viti 2015 - 2016</p> <p>20,000 €</p>	

<p>Hartimi i projektit te mirembajjes</p>	<p>Mbikqyrja e kontraktuesit ne ekzekutimit te mirembajjes vjetore te ndriçimit public</p> <p>Realizimi I mirembajjes vjetore te ndriçimit public</p>	<p>DSHPE</p>	<p>Viti 2015 15,000 €</p>
<p>2. Aplikimi i mirëmbajjes së sistemit të ndriçimit aktual me atë të ndriçimit të ri</p>	<p>a. Organizimi i mbledhjeve me përfaqësuesit e komunitetit si dhe organizimi i mbledhjeve të hapura me komunitet për identifikimin e prioriteteve në fushën e ndriçimit publik</p> <p>b. Identifikimi, studimi, vlerësimi i nevojave për rrjet të ri me qëllim shtimin e mbulimit me shërbim (6.55 km në zonë rurale dhe 3.2 km në atë urbane). Rrugët: Marie Shllaku (Nikolla Teslla); Kolë Mirdita; Drini i Bardhë; Mirush Dakaj; Vëllezërit Gërvalla; Kadri Zeka; Rrugët: Luan Haradinaj; Mulla Kajtaz Broja; Ferat Draga;</p>	<p>DSHPE, Komuniteti</p>	<p>2015 - 2016 Komuna 30,000 €</p>
<p>3. Identifikimi i nevojave për rrjet të ri</p>	<p>Mediat lokale dhe nacionale, web faqja komunale, ligjerata ne shkolla per rendesine e ndriçimit publik etj.</p>	<p>Zyra për informim</p>	<p>Gjate tere vitit</p>
<p>4. Informim qytetar, fushata e ndërgjegjimit dhe sensibilizimit të qytetarëve</p>			

<p>5. Hartimi dhe zbatimi i projektit për zgjerim të rrjetit, aplikimin e ndriçimit të ri eficient LED</p>	<p>a. Hartimi i projektit</p> <p>b. Përcaktimi i prioriteteve</p> <p>c. Sigurimi i mjeteve financiare, dhe</p> <p>d. zbatimi i projektit</p>	<p>a. DSHPA</p> <p>b. DSHPA-Komuna</p> <p>c. DSHPE, USAID, donatorë tjerë</p>	<p>Viti 2015 (a,b,c) 58,000 €</p>
<p>6. Anketimi i qytetarëve (matja e opinionit qytetar për zonat ku implementohen projektet e ndriçimit publik dhe atë para implementimit dhe pas realizimit)</p>	<p>a. Hartimi dhe aprovimi i pyetsorit</p> <p>b. Anketimi, përpunimi dhe publikimi i rezultateve</p> <p>c. Shfrytëzimi i anketimeve të realizuara nga MAPL dhe organizatat tjera</p>	<p>a. Grupi Punues, DSHPE,</p> <p>b. Grupi Punues, DSHP, Zyra e Informimi, OJQ</p>	<p>Janar 2016 1,000 €</p>
<p>7. Raportimi, Informimi</p>	<p>Raportimi i rregullt për progresin në implementimin e planit – te kryetari, kuvendi</p>	<p>Grupi punues, DSHPE</p>	<p>Periudha 6 mujore</p>
<p>8. Rishikimi dhe planifikimi për vitet 2016-2018</p>	<p>Rishikimi i realizimit të planit në fund të vitit 2015 Planifikimi për vitin 2016 – 2018 (adoptimi i planit të aktiviteteve për periudhën 2016 – 2018)</p>	<p>Grupi punues, DSHPE</p>	<p>Shtator dhe Dhjetor 2015</p>

3.3. Strategjia / plani për Mbledhjen e të Dhënave dhe Komunikimi me Qytetarët

Shërbimi i Zgjedhur: Përmirësimi i Shërbimit të Ndriçimit Publik në Komunën e Klinës

Objektivi : Mbledhja e të dhënave të sakta dhe të vazhdueshme për të mbikqyrur progresin në zbatimin e Planit dhe siguruar matjen e performancës dhe raportimin e rezultatit të Shërbimit të Ndriçimit Publik në Komunën e Klinës.

Mjetet/Burimi I të dhënave	Hapat e mbledhjes së të dhënave	Mënyra e administrimit të mjetit	Përgjegjësia	Kur fillon	Përfundimi
Të dhëna nga agjensitë qeveritare					
KEDS	Informata rreth faturimit dhe shpenzimeve	Zyrtarë Komuna-DSHPE-KEDS	DSHPE	Permanente / mujore	Periodike
ZRRE	Informata rreth tarifave	Zyrtarë	DSHPE	Vjetore	Periodike
Të dhëna nga agjensitë lokale					
Komuna	Informatat-shënime për indikatorët e përcaktuar	Zyrtarë Komunal - DSHPE	Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, GP	Cdo tre mujor	Vjetore
Komuna	Informata rreth infrastrukturës rrugore dhe hapësirave të objekteve publike sipas planeve rregulluese dhe planit zhvillimor komunal	Zyrtarë Komuna-DSHPE - DPUKP	Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, GP	Pas aprovimit të planit	Vjetore
Të dhënat nga qytetarët					
1. Anketimi					
MAPL – donatorë	Realizimi I Përmes Anketimi	Vullnetarë/OJQ	MAPL	n/a	n/a
Komuna	Realizimi I anketimit për projekte specifike para dhe pas implementimit	Vullnetarë / OJQ	Grupi Punues/DSHPE	Para implementimit të projektit	6 muaj pas implementimit të projektit
Komuna	Realizimi I konceptit të Vezhguesve të Trajnuar – monitorimit/vleresimit	DSHP/vullnetarë /OJQ/nxënës	Grupi Punues/DSHP	Qershor	Korrik

IV. PLANII MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

1. Grupi Punues për SIAP do të mbledhet cdo muaj duke filluar nga momenti i aprovimit të planit për të monitoruar progresin e realizimit të Planit të Veprimeve, Mbledhjes së të Dhënave dhe ecurinë e aktiviteteve fizike në terren,
2. Grupi Punues për SIAP do të përgatisë një raport monitorimi cdo 6 muaj duke filluar nga momenti i aprovimit të planit, i cili do të paraqitet nga Kordinatori i Grupit Punues të Kryetari i komunës, takimet e kryetarit me drejtorët e drejtorive komunale, në takim të komitetit për shërbime publike dhe sipas kërkesës edhe në Kuvend Komunal. Raportimi do të ketë si bazë realizimin e Planit të Veprimeve dhe matjen e Indikatorëve të Performancës

4.1. Raport mbi Performancën (Realizimin e Rezultateve) Faktik dhe atë të Synuar

#	Indikatorët e Rezultatit	Vlera Bazë Viti 2014	Synimi Viti 2015	Fakti 2015 (dhjetor 2015)	Përmirësime ose Ndryshime	Synimi 2016
1	% e qytetarëve që deklarojnë se ndjehen shumë të sigurt apo deri diku të sigurt gjatë natës (si rezultat i ndriçimit të rrugëve)	70%	75 %			80%
2	% e km rrugë me ndriçim publik në komunë	6 %	9.5 %			11.6 %
3	% e km rrugë me ndriçim publik në zonën. Urbane	33 %	43 %			60 %
4	% e km rrugë me ndriçim publik në zonën Rurale	2 %	4.7 %			9.5 %
5	% e qytetarëve të kënaqur apo deri diku të kënaqur me ndriçimin publik të rrugëve dhe hapësirave publike	51 %	65%			78%

DREJTORI I SH. P. E.
Gjokë LESHAJ

